

INVESTITOR
“Metal - Construzion” SH.P.K.

Prishtinë

RAPORTI VLERËSIMIT TË NDIKIMITNË MJEDIS PËR FABRIKËN PËR
PRODHIMIN E RËRËS ABRAZIVE (GËRRYESE) NGA SKORJET E
NIKELIT, BAKRIT DHE METALET FERRORE, JANJEVË - LIPJAN

Prishtinë, Nëntor – 2025

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKËN PËR
PRODHIMIN E RËRËS ABRAZIVE (GËRRYESE) NGA SKORJET E NIKELIT
DHE BAKRIT, NGA KOMPANIA “METAL – KONSTRUZION” SH.P.K, ZONA
KADASTRALE JANJEVË, KOMUNA LIPJAN**

Ngastra me numër P – 71409033 – 00922-0, zona kadastrale Janjevë, komuna e Lipjanit

	Emri I Investitorit
Aplikuesi	Ismet Kastrati, Pronar
Investitori	Metal - Construzion SH.P.K.,
Adresa:	Prishtinë
Lokacioni i Fabrikës	Janjevë, Lipjan
Tel:	+383 44 - 829– 912
Email:	mconstruzion@gmail.com

Investitori:

“Metal - Construzion” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktaril@gmail.com

+383 49 588 634

Prishtinë, Nëntor - 2025

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE.....	1
2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3. PËR KOMPANINË.....	3
a) Vendndodhja e Fabrikës	3
b) Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit.....	6
c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	7
d) Lënda e pare dhe lënda ndihmëse	8
e) Përshkrimi detal i procesit teknologjik	8
Komponentët hyrëse të procesit teknologjik.....	9
f) Rezervarët	14
4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	15
5. GJENDJAAKTUALE E MJEDISIT	16
5.1. Ndotësit Kryesorë	16
5.2. Transporti rrugor	17
5.3. Mbeturinat e ngurta	17
5.4. Karakteristikat sizmike	18
5.5. Efektet vizuale (peizazhi).....	18
5.6. Hidrografia	18
5.8. Flora dhe Fauna.....	19
6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	21
6.1. Ndikimet në ajër.....	21
6.2. Ndikimet në tokë	21
6.3. Ndikimet në ujë	22
6.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	22
6.5. Ndikimet nga zhurma.....	23
6.6. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	23
7. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	24
8. PËRSHKRIMI I MASAVE.....	26
8.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	26
8.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë dhe ujë.....	27
8.3. Masat për mbrojtje nga zhurma	29
8.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	30

8.5. Masat e marra për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale	30
8.6. Masat rehabilituese	30
9.PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	32
10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	33
11. PËRFUNDIM.....	34
12. FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE	35
13. LITERATURA E PERDORUR	36

Lista e Figurave

Figura 1.Shtrirja hapësinore e lokacionit të kompanisë në territorin e komunës së Lipjanit.....	4
Figura 2. Distanca e kompanisë me qytetin e Prizrenit	4
Figura 3. Distanca e kompanisë nga shtëpitë e banimi	5
Figura 4. Fabrika ne raport me kompanitë tjera.....	5
Figura 5. Distanca e kompanisë me Zonën e Mbrojtur.....	6
Figura 6. Rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit	9
Figura 7.Larja e skorjes se Nikelit dhe Bakrit	11
Figura 8.Elevatori i produktit të thatë	12
Figura 9.Seperator i për ndarjen e materialit.....	12
Figura 10. Bunkeri pranues i lëndës e pare	12
Figura 11. Shiriti transportues i lëndës së parë	12
Figura 12.Tersja e lëndës së parë	13
Figura 13.Produkt i gatshëm	13
Figura 14.Produkt i paketuar.....	13
Figura 15. Hidrografia e Komunës së Lipjanit	19

Lista e Tabelave

Tabela 1. Kodet e mbeturinave te cilat përdoren si lende e parë	14
---	----

1. HYRJE

Për hartimin e raportit të VNM-së mbi ndikimin në mjedis për Fabrikën për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit në Janjevë të Komunës së Lipjanit, nevojitet të bëhet një analizë e ndikimeve të mundshme në mjedis ku përmes këtij raporti të VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në hapësirat e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit duke marr parasysh mjedisin e gjerë.

Vlerësimi i ndikimit në mjedisin për investimet kapitale si në vendet e zhvilluara të Evropës e tani edhe te ne është obligim dhe është bërë praktikë e përhershme dhe paraqet një nga instrumentet shumë efikase në mbrojtjen e mjedisit.

Në Kosovë vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) ka filluar të zbatohet pas miratimit të ligjit për mbrojtjen e mjedisit 2003/09, ku qartë janë të precizuara obligimet e investitorit në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë investimeve kapitale.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis është bërë me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis i Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit me infrastrukturën përcjellëse, me të gjitha aktivitetet punuese në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis i Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit në Janjevë, Komuna e Lipjanit është punuar duke u bazuar në projektin e ndertuar, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth fabrikës si dhe dokumenteve teknike ekzistuese.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti për Fabrikën për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e vlerave të ndotjes në kufijtë e lejuar gjatë:

- Fazës së aktiviteteve punuese
- Fazës së përfundimit të aktiviteteve punuese.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të respektohen gjatë fazës së procesit të punës të fabrikës në fjalë.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit, në Janjevë të Komunës së Lipjanit me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të përfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261.
- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për kimikate,

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga të ndotjes burimet e palëvizshme;
- Udhëzimi administrativ Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor;
- Udhëzim Administrativ MPMH - Nr. 27/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga ambalazhet dhe paketimet
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 11/2018 për vlerat kufitare të emisioneve të materieve ndotëse në tokë

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

3. PËR KOMPANINË

Metal – Construzion Shpk, është kompani e regjistruar në Agjencinë për regjistrimin e bizneseve në Kosovë (ARBK) me numër unik identifikues 8103779942 dhe selinë e ka në adresën Sheshi Nënë Terezë Nr.48/C në Prishtinë, e cila përfaqësohet nga Ismet Kastrati pronar. Sipas dokumenteve të regjistrimit në ARBK, veprimtaria kryesore e kompanisë është: Prodhimi i produkteve (gërryerjes) nga skorjet, për të cilën dhe do të bëjmë raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Kompania merret edhe me veprimtari tjera siç janë: Përpunimi i mineraleve dhe proceset fizike si thyerja, larja dhe seperimi, ndërtimi i larte dhe ndërtimi i ulet, tregti me shumicë dhe pakicë. Objekti i kompanisë për prodhimin e rërës abrazive (gërryerjes) nga skorjet e nikelit dhe bakrit, është e vendosur në Janjevë. Kjo kompani operon që nga viti 2007, dhe ka diku mbi 100 punëtor.

a) Vendndodhja e Fabrikës

Lokacioni i Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit në Janjevë të Komunës së Lipjanit gjendet në territorin e komunës së Lipjanit, në fshatin Janjevë, zone industriale, në një lartësi prej 891 metra lartësi mbidetare dhe objektet më të afërta të banuara janë rreth 2 km nga kjo zonë.

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Koordinatat gjeografike të kësaj komunë shtrihen rreth 42°31 48 V dhe 21°08 19 L. Përmes territorit të komunës rrjedh lumi Sitnica, përreth dhe përgjatë të cilit shtrihen sipërfaqet më të pëlleshme bujqësore, të përshtatshme për prodhimtari bujqësore intensive.

Kompania Metal - Construzion SH.P.K., gjendet në ngastrën kadastrale me numër: P-71409033-00922-0; tokë ndërtimore, qirambajtje për 99 vite, Zyra Kadastrale Komunale, Lipjan, datë 25.02.2021 Nr 638/2021.

Kompania objekti e ka me qera për 99 vjet.

Lokacioni ku gjendet Fabrika për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit shihet në foto si në vijim:




Figura 1. Shtrirja hapësinore e lokacionit të kompanisë në territorin e komunës së Lipjanit

Fabrika për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit në Janjevë , ndodhet 12.0 km largët nga komuna e Lipjanit.




Figura 2. Distanca e kompanisë me qytetin e Prizrenit

Distanca më e vogël midis objektit të fabrikës dhe shtëpive më të afërta është mbi 120 metra. Kjo largësi konsiderohet e mjaftueshme për të kufizuar ndikimet potenciale që mund të vijnë nga aktivitetet e qendrës, si zhurma, pluhuri dhe lëvizja e mjeteve transportuese, në mënyrë që të ruhet cilësia e jetës për banorët përreth.



Figura 3. Distanca e kompanisë nga shtëpitë e banimi

Në afërsi të lokacionit të propozuar ndodhen disa objekte me funksione ekonomike, të cilat gjenden me një parcel dhe disa ngjit me të. Më poshtë paraqiten objektet kryesore me distancat përkatëse nga qendra.



Figura 4. Fabrika në raport me kompanitë tjera

Afër fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit, ne një distance prej me shume se 2 km gjendet një zone e mbrojtur.



Figura 5. Distanca e kompanisë me Zonën e Mbrojtur

b) Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit

Projekti përfshin një objekt industrial tashmë të ndërtuar, i cili është dedikuar për përpunimin e skorjeve metalike të nikelit dhe bakrit me qëllim prodhimin e rërës abrazive (gërryese). Objekti ndodhet brenda një zone industriale të përshtatshme dhe përmban të gjitha hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit teknologjik.

Objekti kryesor i prodhimit është i ndërtuar tashme me material nga betoni dhe muret nga bllokat. Ai përfshin hapësirat e brendshme ku ndodhen makineritë e thërmimit, sitjes dhe klasifikimit të materialit. Objekti është i mbyllur dhe i pajisur me ndriçim, ventilim dhe instalime të nevojshme teknike për zhvillimin e aktivitetit.

Zona e magazinimit të lëndës së parë është e organizuar në platformë të fortë, e përshtatshme për shkarkimin, depozitimin dhe manipulimin e skorjeve të nikelit dhe bakrit. Kjo zonë siguron qasje të lehtë për automjetet transportuese dhe makineritë ngritëse.

Zona e magazinimit të produktit final është e dedikuar për grumbullimin e rërës abrazive të përpunuar. Ajo përfshin hapësira të përshtatura për depozitimin e fraksioneve të ndara, zakonisht në thasë industriale (big bags) ose kontejnerë të mbyllur.

Pajisjet teknologjike janë të vendosura brenda objektit dhe përfshijnë thërrmuesin mekanik, sitat vibruese për klasifikimin e materialit, transportuesit mekanikë, si dhe sistemet e aspirimit dhe filtrimit të pluhurit. Vendosja e tyre është bërë në mënyrë lineare për të siguruar rrjedhën e pandërprerë të procesit.

Zona e ngarkim–shkarkimit ndodhet në pjesën e jashtme të objektit dhe është e pajisur me qasje të drejtpërdrejtë për automjete transportuese. Kjo zonë mundëson qarkullim të sigurt të lëndës së parë dhe produktit final pa penguar procesin e brendshëm.

Infrastruktura mbështetëse përfshin rrjetin elektrik, sistemin e ndriçimit, rrjetin e brendshëm të ujërave të sipërfaqshme, qarkullimin e brendshëm për makineri, dhe hapësira administrative nëse kërkohen nga aktiviteti.

Objekti është i pozicionuar brenda një perimetri të rrethuar, gjë që siguron kontroll të qasjes, rrit sigurinë dhe minimizon ndërhyrjet nga jashtë. Organizuari fizik i mbështet funksionimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe me ndikim minimal në mjedis.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit përfshin kryerjen e të gjitha proceseve teknologjike që mundësojnë prodhimin e rërës abrazive nga skorjet e nikelit dhe bakrit. Aktiviteti zhvillohet brenda objektit ekzistues industrial dhe funksionon në mënyrë të vazhdueshme, duke siguruar rendiment stabil dhe kontroll të plotë të parametrave teknikë dhe mjedisorë.

Gjatë fazës operative kryhen këto veçori dhe procese kryesore:

Pranimi dhe magazinimi i lëndës së parë, ku skorjet transportohen me automjete, shkarkohen në platformën e dedikuar dhe vendosen në zonën e magazinimit. Lënda e parë kontrollohet vizualisht dhe përgatitet për futje në proces.

Procesi i thërrmimit, i cili realizohet përmes makinerive mekanike brenda objektit. Skorjet shtypen dhe reduktohen në madhësi të përshtatshme për klasifikim të mëtejshëm. Ky proces zhvillohet në hapësirë të mbyllur për të kufizuar përhapjen e pluhurit.

Sitja dhe klasifikimi, ku materiali i thërrmuar kalon nëpër sita vibruese dhe ndahet sipas fraksioneve granulometrike. Pajisjet e sitjes janë të pajisura me mekanizma transportues dhe sisteme aspirimi për minimizimin e ndotjes së ajrit.

Magazinimi i produktit final, ku rëra abrazive e përpunuar vendoset në thasë industriale (big bags) ose kontejnerë të mbyllur, në varësi të fraksionit. Materiali ruhet në zonë të dedikuar deri në momentin e transportit.

Ngarkim–shkarkimi dhe transporti, që kryhet me mjete transportuese brenda dhe jashtë objektit, duke siguruar qarkullim të rregullt të lëndës së parë dhe produktit final, pa penguar proceset e brendshme.

Menaxhimi i mbetjeve teknologjike, ku fraksionet e papërdorshme, pluhuri i filtruar dhe çdo material tjetër i mbetur mblidhen veçmas dhe dorëzohen tek operatorë të licencuar për trajtim, riciklim ose asgjësim të kontrolluar.

Funksionimi i sistemeve ndihmëse, ku përfshihen furnizimi me energji elektrike, ventilimi, aspirimi i pluhurit, ndriçimi dhe mirëmbajtja teknike e pajisjeve. Këto sisteme sigurojnë funksionim të qëndrueshëm dhe të sigurt të procesit.

Faza operative zhvillohet brenda hapësirave të kontrolluara industriale dhe është projektuar në mënyrë që të minimizojë ndikimet mjedisore, të ruajë sigurinë e punëtorëve dhe të garantojë funksionim efikas të linjës së prodhimit.

d) Lënda e pare dhe lënda ndihmëse

Lënda kryesore e përdorur në proces është **skorja metalike e nikelit dhe bakrit**, e cila merret në formë të ngurtë dhe përpunohet përmes thërrmimit dhe sitjes deri në formën e rërës abrazive. Lëndët ndihmëse përfshijnë: energjinë elektrike si burim kryesor për pajisjet e prodhimit, Materiale për paketim, si thasë industriale dhe paleta.

e) Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Kompania Metal - Construzion SH.P.K. do të bënë prodhimin dhe shitjen e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit me cilësi të lartë. Kjo skorje ka vetitë e mira gërryese - abrasive me ç'rast sipërfaqen në të cilën përdoret e pastron me cilësi të lartë. Skorjet e grimecuara të Nikelit dhe Bakrit përdoren gjerësisht në konstruksione metalike për të hequr (gërryer) ngjyrën e vjetër, ndryshkun apo lloje të tjera të ndotësve që shkaktohen në çelik apo sipërfaqet e tjera të forta. Duke përdorur skorjet e Nikelit kryhet përpunimi me cilësi të lartë i pastrimit për lloje të ndryshme të sipërfaqeve, kjo ofron siguri dhe mbrojtje efektive kundër korrozionit të metalit apo materialit tjetër. Një foto e materialit të rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit është paraqitur në figurën në vijim:



Figura 6. Rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit

Pas furnizimit të materialit të skorjes së Nikelit dhe Bakrit i cili transportohet me kamiona në repartin prodhues të kompanisë në Janjev , dhe deponohet në vendin e parapare për deponim. Në bazë të kapacitetit numri i pajisjeve mund edhe të rritet. Punimet e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit zhvillohen sipas projektit kryesor ku janë përcaktuar të gjithë parametrat tekniko-teknologjik për prodhim.

Në fillim bartet lënda e parë, skoriet e Nikelit dhe përmes bunkerit të lëndës së parë dhe transportit shiritor nga goma bartet deri në tharsen rrotulluese të lëndës së parë deri në 140°C dhe pastaj përmes elevatorit materiali bartet deri në seperator ku bëhet ndarja e materialit në granula nga 0.2-0.5mm dhe pastaj pakëtohet dhe dërgohet në destinacion të caktuar.

Shema e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit duket:



Komponentët hyrësë të procesit teknologjik - Fazat e prodhimit në Fabrikën për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit përfshijnë:

- Transportin e lëndës së parë nga bunkeri pranues deri në tharësë,
- Tharja rrotulluese e materialit
- Seperimi i materialit

Skorjet e Nikelit së pari përmes makinave për ngarkim, ngarkohet në bunkerin pranues dhe më pastaj përmes shiritit transportues të gomës deri te tharësja e materialit. Pasi të thahet materiali kalon në Elevator vertikal i cili materialin e tharë e dërgon në seperator, në të cilin pastaj ndahet materiali sipas granulacionit të dëshiruar.

Komponentët dalëse në procesin teknologjik - Komponentët dalëse nga procesi teknologjik që zhvillohen në kompleksin e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit janë:

- Rëra abrazive (gërryese)
- Zhurma.
- Mbeturinat e ngurta
- Sterili

Rëra abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit që del nga seperatori ka vetit e mira gërryese - abrazive me ç ‘rast sipërfaqen ne te cilën përdoret e pastron me cilësi të lartë. Skorjet e grimecuara te Nikelit përdoren gjerësisht te konstruksione metalike për te hequr ngjyrën e vjetër, ndryshkun apo lloje te tjera te ndotësve qe shkaktohen ne çelik apo sipërfaqet e tjera të forta. Duke përdorur rërën abrazive të skorjeve të Nikelit kryhet përpunimi me cilësi te larte i pastrimit për lloje te ndryshme te sipërfaqeve, kjo ofron siguri dhe mbrojtje efektive kundër korrozionit te objektit.

Materiali i deponuar dhe i klasifikuar në seperator paketohet ne makinat për paketim dhe atë ne thasë me peshe 20kg, 50kg dhe 1000 kg. Paketimi i materialit mund të bëhet në formën e kërkuar nga blerësi.

Fraksionet e produktit përfundimtar

Gjatë procesit përfitohen tre fraksione granulometrike të rërës abrazive:

- **Fraksioni I:** deri në 1 mm
- **Fraksioni II:** 1 – 1.5 mm
- **Fraksioni III:** 1.5 – 2.5 mm

Këto fraksione përdoren në aplikime të ndryshme industriale, varësisht kërkesave të konsumatorëve dhe specifikimeve teknike.

Sipas rezultateve te fituara nga analizat si dhe nga përvoja e blerësve Fraksionet 2 dhe 3 I plotësojnë te gjitha parametrat për përdorim për procesin e zallitjes ndërsa fraksioni 1 për shkak te pluhurit dhe mikrofibrave te cilët gjinden ne te nuk mund te përdoret pa u bere larja paraprake e skorjes.

Kërkesa për fraksionin 1 është e madhe, sepse ky fraksion përdoret për zallitjen e sipërfaqeve metalike me trashësi te vogël si ne industrinë automobilistike, dhe si shtese për industritë tjera si industria e llaqeve, industria e pllakave te betonit etj.

Ne vazhdim paraqesim projektin për procesin e larjes se skorjes, respektivisht zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese te riciklimit te skorjes se Nikelit dhe Bakrit. Bllok diagrami I procesit te larjes se skorjes është paraqitur ne vijim.




Figura 7.Larja e skorjes se Nikelit dhe Bakrit

Skorja e Nikelit dhe Bakrit me ndihmën e lugës ngarkuese merret nga deponija dhe vendoset ne dozerin 1, i cili ka kapacitet 10 m3, nga i cili ne mënyre te kontrolluar dozohet ne larësen me spirale. Gjate lëvizjes neper spirale dhe ne kontakt me ujin skorja pastrohet. Nga larësja me spirale skorja bie ne shiritin transportues i cili e dërgon ne vendin e paraparë për deponim ne sipërfaqe te hapur, i cili do te jetë i rrethuar ne mënyrë qe te mos behet shpërndarja e skorjes, Ne këtë vend skorja lihet se paku 24 ore ne manure qe te behet edhe tharja natyrore dhe qe te zvogëlohen shpenzimet e lendes djegëse (naftës) për procesin e tharjes ne furrën rrotulluese. Uji i cili përdoret për pastrimin ne larëse si dhe uji i cili dekantohet nga deponija e skorjes me

ndihmën e kanaleve dërgohet ne rezervarët e parapare për ujë, ku behet filtrimi dhe dekantimi i materialeve te ngurta e pastaj me ndihmën e pompave kthehet përsëri ne cikël prodhues.



Figura 8. Elevatori i produktit të thatë



Figura 9. Seperatori për ndarjen e materialit



Figura 10. Bunkeri pranues i lendes e pare



Figura 11. Shiriti transportues i lëndës së parë



Figura 12. Tersja e lëndës së parë



Figura 13. Produkt i gatshëm



Figura 14. Produkt i paketuar

Materiali i deponuar dhe i klasifikuar në seperator paketohet ne makinat për paketim dhe atë ne thasë me peshe 20kg, 50kg dhe 1000 kg. Paketimi i materialit mund të bëhet në formën e kërkuar nga blerësi.

f) Rezervarët

Rezervari i ujit - Në lokacionin e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit është i vendosur një rezervuar i ujit me kapacitet 50.000 litra dhe shfrytëzohet për nevojat e ndryshme të fabrikës, si për stërpikjen e platformës për pastrim etj.

Rezervari i naftës - Në lokacionin e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit është i vendosur një rezervuar i naftës me kapacitet 33.000 litra dhe nevojitet për vendosjen e lëndës djegëse për tharjen e lëndës së parë në tersen rrotulluese.

Kur arrihet një sasi e mjaftueshme e materialeve të përpunuara, ato ngarkohen në automjete transportuese të kompanisë ose operatorëve të kontraktuar brenda vendit të cilët merren me eksport jashtë vendit

Tabela 1. Kodet e mbeturinave te cilat përdoren si lende e parë

Kodet e mbeturinave	Përshkrimi I Mbetuarnave	Trajtimi I Mbeturinave
10 06 01	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar	Trajtimi ne furre dhe prodhimi i Gridit per perdorim per korrozion
10 06 02	Zgjyra dhe shkuma nga prodhimi primar dhe sekondar	Trajtimi ne furre dhe prodhimi i Gridit per perdorim per korrozion
10 10 03	Llumrat nga Furra për shkrirje	Trajtimi ne furre dhe prodhimi i Gridit per perdorim per korrozion
16 01 17	Metale ferore	Trajtimi ne furre dhe prodhimi i Gridit per perdorim per korrozion

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Gjatë fazës së planifikimit të projektit janë shqyrtuar disa alternativa të mundshme për vendndodhjen e aktivitetit, me synim zgjedhjen e lokacionit që siguron ndikimin më të ulët mjedisor, qasje të lehtë logjistike dhe kushte të përshtatshme për procesin teknologjik.

Alternativa 1 – Lokacioni aktual (objekti ekzistues industrial)

Lokacioni i zgjedhur është një hapësirë industriale tashmë e zhvilluar, që ka infrastrukturë të përfunduar, qasje të lehtë transportuese dhe distancë të sigurt nga zonat e banuara. Përdorimi i objektit ekzistues minimizon ndërhyrjet ndërtimore, shmang përdorimin e tokave të reja dhe ul ndjeshëm ndikimet mjedisore krahasuar me ndërtimin e një objekti të ri.

Alternativa 2 – Ndërtimi i një objekti të ri në zonë tjetër

Kjo alternativë do të kërkonte ndërtim të ri, hapje të sipërfaqeve të paprekura dhe investime të mëdha në infrastrukturë. Do të krijonte ndikime të konsiderueshme mjedisore gjatë fazës së ndërtimit, rritje të konsumit të tokës dhe rreziqe më të mëdha për ndotje gjatë implementimit. Për këto arsye, alternativa është konsideruar më pak e favorshme.

Alternativa 3 – Vendosja në zonë të hapur të paurbanizuar

Përdorimi i një lokacioni të pa zhvilluar do të rëndonte në mënyrë të panevojshme mjedisin për shkak të pastrimit të terrenit, mungesës së infrastrukturës së gatshme, qasjes së vështirë dhe rrezikut më të madh për ndikim në ekosistem. Kjo alternativë është vlerësuar si më pak e arsyeshme, pasi synimi i projektit është riciklimi i materialeve dhe funksionimi brenda zonave të përshtatshme industriale.

Nga krahasimi i të gjitha alternativave, lokacioni aktual rezulton opsioni më i arsyeshëm dhe më i qëndrueshëm. Ai shmang shtrirjen në toka të reja, ka infrastrukturën e nevojshme të përfunduar, ul ndikimet ndërtimore dhe garanton operim të sigurt pa rrezikuar komunitetin përreth.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja aktuale në Komunën e Lipjanit karakterizohet nga një përzierje sfidash dhe mundësish. Një nga çështjet kryesore është zhvillimi ekonomik, i cili po shfaqet në rritje përmes investimeve në industri dhe bujqësi. Megjithatë, janë të pranishme edhe probleme mjedisore, si ndotja e ajrit dhe menaxhimi i mbetjeve. Infrastruktura e transportit po përmirësohet, por ende ka nevojë për modernizim të mëtejshëm. Popullsia e Komunës së Lipjanit është diversifikuar, me një numër të madh të rinjve që kërkojnë mundësi pune. Mjedisi natyror ka nevojë për mbrojtje dhe rehabilitim, veçanërisht pas ndotjes nga aktivitetet industriale dhe urbanizimi. Aktivitetet për pastrimin e zonave dhe mbjelljen e bimëve vendase janë të rëndësishme për rikthimin e biodiversitetit. Për më tepër, ka nevojë për rritje të ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore dhe përfshirje të komunitetit në projekte që promovojnë mbrojtjen e mjedisit. Komuna e Lipjanit ka potencial të madh për zhvillim të qëndrueshëm, nëse adresohen këto sfida.

5.1.Ndotësit Kryesorë

Ndotësit kryesorë në Komunën e Lipjanit përbëjnë një shqetësim të rëndësishëm për mjedisin dhe shëndetin e popullsisë, duke rezultuar nga aktivitete industriale, urbanizimi dhe bujqësia. Ndotja e ajrit është një nga problemet kryesore, e cila vjen si pasojë e emisioneve nga industria, transporti dhe ndërtimi. Gazrat si dioksidi i karbonit (CO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe grimcat e pluhurit (PM₁₀ dhe PM_{2.5}) janë të pranishme në nivele që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e qytetarëve dhe cilësinë e ajrit. Ndotja e ujit gjithashtu është një shqetësim, ku aktivitetet bujqësore sjellin shkarkime të pesticideve dhe plehrave kimikë në lumenj dhe burime të ujit, ndërsa derdhjet e ujërave të ndotura nga industria dhe menaxhimi i pamjaftueshëm i mbetjeve kontribuojnë në këtë problem. Ndotja e tokës është një tjetër aspekt, me shkarkimin e mbetjeve të ngurta dhe kimikëve që ndikon në cilësinë e tokës dhe biodiversitetin. Ndërsa ndotja akustike, për shkak të zhurmave nga trafiku dhe aktivitetet industriale, ndikon në cilësinë e jetës dhe shëndetin mendor të banorëve. Menaxhimi i dobët i mbetjeve, që çon në akumulimin e tyre në vende të hapura, krijon probleme për ambientin dhe shëndetin publik. Këto ndotës kërkojnë vëmendje të madhe dhe masa të menjëhershme për të minimizuar ndikimin e tyre, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të integruar për menaxhimin e ndotjes, përfshirë monitorimin dhe implementimin e politikave mjedisore.

.

5.2.Transporti rrugor

Transporti është një ndër komponentët kyç për përmbushjen e kërkesave për lëvizje ditore. Është faktor përmbajtësor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor, si dhe luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore ndërmjet hapësirave dhe destinimeve të tyre. Infrastruktura e transportit duhet të përballojnë kërkesat e vazhdueshme për sa i përket kërkesës për transport, tendencave të reja, presioneve shoqërore dhe efikasitetit të buxhetit. Lipjani është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme nacionale dhe evropiane N 25 (E 752) dhe N2 (E 65), ndërsa hekurudha kryesore Mitrovicë/Fushë Kosovë dhe Ferizaj/Shkup e cila kalon në mes të Lipjanit me stacionin e pasagjerëve dhe trafikut tëmallrave, e lidhë Kosovën me korridorin e Hekurudhor panevropian. Ky pozicion gjeografik i ofron Komunës së Lipjanit mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor-hekurudhor dhe ajror, për shkak se Aeroporti i vetëm ndërkombëtar ndodhet në Komunën e Lipjanit dhe është nga qendra vetëm 15 km. Komuna e Lipjanit karakterizohet me tri lloje të transportit atë rrugor, hekurudhor dhe atë ajror. Infrastruktura e transportit në komunën e Lipjanit shtrihet në një gjatësi prej 433.3 km, e cila gjatësi përbëhet nga infrastruktura rrugore me gjatësi prej 412 km (ose 95%), infrastruktura hekurudhore me një gjatësi prej 8.9 km (ose 2%) dhe infrastruktura ajrore me një gjatësi prej 11.4 km (ose 3%). Në komunë e Lipjanit për nga karakteri ekzistojnë katër nivele të rrugëve, duke filluar nga autoudha, rrugët nacionale, rajonale dhe ato lokale. Në përputhje me Ligjin, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për menaxhim, ndërtim, rindërtim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rrugëve rajonale. Ndërsa, Komuna e Lipjanit është përgjegjëse për rrjetin rrugor lokal.

5.3. Mbeturinat e ngurta

Mbeturinat komunale përmbajnë një game të gjerë të ndotësve, përfshirë metalet e rënda, cianidin (CN), Hidrokarburet policiklike, bifenilet e polikloruara, azbestin, metanin, amoniakun dhe hidrogjen sulfidet të cilat kanosin tokat përreth. Klasifikimi i mbeturinave bëhet sipas Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina dhe ndahen në mbeturina komunale, komerciale, industriale dhe medicinale. Ndërsa sipas nivelit të rrezikshmërisë ndahen në mbeturina Inerte, të parrezikshme, dhe të rrezikshme. Një gjenerim mesatar i mbeturinave në nivel komune për kokë banori është siguruar nga baza e të dhënave nga operatori K.R.M “Pastrimi”, dhe planet komunale. Operatori përcakton sasinë përmes peshimit të mbeturinave të përziera komunale, nga ku rezultojnë 13,033 ton/vit mbeturina të gjeruara në komunën e Lipjanit, 56,673 banorë të shërbyer, gjenerimi për kokë banori rezultojnë 229.9 kg/banorë/vit. Shifra mbi gjenerimin e mbetjeve për

vit është marrë për të tre kategoritë e klientëve, duke qenë se operatori nuk aplikon gjenerimin ndaras sipas kategorive.

5.4. Karakteristikat sizmike

Sizmikja mikro-regjionale e këtij lokacioni dallohet me mundësi të dridhjeve të tokës të intensitetit prej 6-7 shkallë të Merkalit. Sipas hartave sizmike të regjionit, hapësira e gjerë e hulumtuar nuk i përket një intensiteti të njëjtë të dridhjeve sepse varet nga karakteristikat gjeologjike të tokës, thellësisë së ujërave nëntokësore etj.

Sizmiteti i terrenit paraqet parametër me interes në vete për analizën e ndikimeve të mundshme në fushën studimore të mjedisit.

Sipas hartave sizmike, hapësira e gjerë e hulumtuar i takon intensiteteve të ndryshme reversibile që do të paraqiten në tabelën në vijim.

5.5. Efektet vizuale (peizazhi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin kompleks i Fabrika për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit -mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marr parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike efektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethit në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Lokacioni ku gjendet Fabrika për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit, në hyrje në parcelë-ngastër e deri në fund të ngastrës kemi një disnivel-pjerrtësi. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Fabrika për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, prandaj nuk ndikon në shikuesin.

5.6. Hidrografia

Në aspektin hidrografik ujërat në komunën e Lipjanit i takojnë pellgut të Detit të Zi, ndërsa lumenjtë më të mëdhenj janë lumi Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Në përgjithësi rrjeti hidrografik është i pasur dhe me potencial ujorë të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumëvjeçare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madh në Komunë e Lipjanit i cili degët më të zhvilluara i ka në anën lindore, ndërsa degët kryesore hidrografike të anës lindore janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi Sazlisë ndërsa, në anën perëndimore lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit. Sasitë më të

mëdha të të reshurave janë gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet dhe kur kemi edhe paraqitjen e kënetave, posaçërisht në tokat të cilat nuk e lëshojnë ujin.




Figura 15. Hidrografia e Komunës së Lipjanit

5.8. Flora dhe Fauna

Ndikimi i fabrikës në domenin e florës dhe faunës paraqet dukuri që kërkon shqyrtim të kujdesshëm, në kuptim të evidencimit të pasojave të ndryshme të mundshme negative dhe zvogëlimit të tyre brenda kufijve të pranueshëm. Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut.

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore. Në ngastrën ku është Fabrika për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit ka bimësi e cila është karakteristike për këtë lartësi mbidetare, shkurre të ndryshme dhe drunjë me zhvillim të ulët, dëllinja të ndryshme dhe djerrina për shkak të përbërjes nga guri gëlqeror. Pyjet e këtij regjioni kryesisht janë pyje të llojit gjethor dhe përbëjnë një numër të madh të llojeve, si që janë bungu, qarri etj. me rritje të ulëta dhe mesatare. Në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethinë të zonës kur realizohet projekti, kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulëta barishtore posaçërisht bar të

egër, kultura periodike bujqësore, si dhe të gjitha pemët frutore, thana, gështenja, lajthia, arra, molla, dardha etj. Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marr për bazë edhe të dhënat nga banorët si dhe densitetin e banorëve, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpira, ujku, derri i egër iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë mijtë, prej zvarranikëve gjarpri i zakonshëm, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, insektet krahëfortë, krahëlusporë, mizat etj., ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja, etj.

Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me funksionimin e fabrikës.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësim i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e proceseve (veprimeve) që zhvillohen në Fabrikën për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakri, tregojnë se deri të kuantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithëpërfshirëse. Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Gjatë punës kontinuele të Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit vije deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse grimcore gjatë procesit të prodhimit dhe atë gjatë transportit me kamion, transportit me shirita gome, tharjes, bartjes me elevator, seperimit dhe paketimit. Gjithashtu nga puna e automjete tjera që manipulojnë nëpër platonë e fabrikës, avullimi i karburanteve të lëngëta, krijohet zhurmë nga motorët e pajisjeve të fabrikës, në mënyrë indirekte mund të vije deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër fabrikës).

6.1. Ndikimet në ajër

Gjatë funksionimit kontinuel në kompleksin e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit, vije deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i grimcave të rërës si dhe gazrave dhe avullimi i karburanteve të lëndës djegëse dhe vajrave që përdoren për lubrifikimin e pajisjeve të cilat përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrim të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, H_x, SO₂ dhe Pb .

Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para së gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe gjendjes teknike të pajisjeve në fabrikë, duke përfshirë pajisjet për depluhim te elevatori dhe separatori si dhe shiriti prej gome që bënë transportin e lëndës së parë deri te tharësja e lëndës së parë, tharësja rrotulluese.

6.2. Ndikimet në tokë

Toka (dheu) si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vije deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja. Në aspektin e ndotjes së dheut në fazën e shfrytëzimit të fabrikës ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellin përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platosë së fabrikës dhe me fundërrimin e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të fabrikës pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vije si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në

vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin. Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër fabrikës varet para së gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së fabrikës, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e fabrikës.

6.3. Ndikimet në ujë

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vije deri të shpërthimi e rezervarit me karburant të automjeteve, gjë e cila ka gjasa shumë, shumë të vogla. Pastaj edhe gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit të Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit në sipërfaqet shërbyese për komunikacionin mund të vije deri te sedimentimi i grimcave të pluhurit dhe materieve ndotëse që janë si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike i fshirjes së gomave të automjetit i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga pajisjet e fabrikës dhe i fundërrimeve nga atmosfera etj.

Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit pritet të jenë gjatë sezoneve të dimrit kur kemi të reshura më të mëdha dhe shpëlarje më të madhe. Përqendrimet e ndotësve të sedimentuar në platon e fabrikës drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga sasia e pluhurit në fabrikë. Përqendrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të reshurat atmosferike ku përqendrimet më të mëdha janë 5-10 minutat e para të shpëlarjes së sipërfaqes së platosë nga personeli apo nga të reshurat atmosferike.

6.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vije deri te ndikimet në florë dhe faunë mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk do të kemi zhdukje të vegetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe në platonë e fabrikës kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentrim të vogël të ndotësve.

E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, bile nëpër hapësirat e objektit vërehet një vegetacion i vrullshëm me drujë dhe bimësi të llojllojshme.

6.5. Ndikimet nga zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension në koncentrim të njeriut në punë etj.

Lokacioni ku është Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga zhurma e pajisjeve, që janë pjesë e procesit teknologjik të prodhimit të rërës abrazive duke filluar nga transporteri shiritor, tharësja, elevatori, seperatori, ventilatori i filtrit, breneri etj.. Sipas gjendjes faktike të kompleksit të fabrikës në lokacionin e analizuar mund të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB është nën vlerën e lejuar prej 60 dB.

6.6. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Ndikimet në raste aksidentale mund të jenë si rrjedhojë e ndonjë dështimi të pajisjeve të fabrikës dhe ndodhjes së zjarrit. Dështimi i këtyre pajisjeve mund të qonte deri te lëndimi i punëtorëve dhe ndotja e mjedisit.

Situata aksidentale që mund të ndikojë në ndotjen mjedisore nga fabrika është edhe shfaqja e zjarrit apo nga ndonjë rrjedhje aksidentale.

Zjarri në gjatë faze se ndërtimit dhe punës së fabrikës mund të shkaktohet nga:

- Përdorimi i flakëve të hapura;
- Përdorimi i pajisjeve të saldimit, bocave të lëndës djegëse për saldim etj.

7. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore (VNM)

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit (SMM)

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës (ACJ)

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.
- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.

- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore (SNASh)

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhisë së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhisë së këtyre incidenteve.

8. PERSHKRIMI I MASAVE

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit në mjedis, si dhe në bazë të vlerësimit të lokacionit ku është fabrika, ku në bazë të projektit kryesor të ndërtimit dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, fabrika me veprimtarinë kontinuele të saj në lokacionin e analizuar sipas këtij raporti nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por me gjithë atë duhet të parashihet së në rast se vije deri te ndotja duhet të ndërmerren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor.

Me qëllim të zvogëlimit të mëtejme të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta në përputhje me ISO 45001:2018, Occupational Health&Safety Management System dhe implementimi i ISO 14001:2015, Environmental management systems.

8.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Qëllimi i hartimit të VNM-së, pra është përcaktimi i ndotjeve të mundshme në mjedis i Fabrikës dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen e mjedisit rrethues.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës së ndërtimit dhe zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në Fabrikë, kompania:

- Do të pajiset me sistemin e filtrimit të pluhurit që do të mundë të shkaktoheshin në hapësirën punuese të fabrikës dhe pastaj ato grimca përmes filtrit me thasë të deponohen në hambarë e pastaj hedhen sipas procedurave ligjore;
- Do të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve të procesit të prodhimit të cilat edhe do të jenë burim i emisioneve të pluhurit;
- Do të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe sistemit të ventilimit të pluhurit, grimcave të pluhurit në filtër, hambar;
- Do të bëhet kontrollimi i rregullt i sistemit të ventilimit dhe do të ndërmerren masat e duhura;
- Në hapësirat e objektit të fabrikës me qëllim të eliminimit të kundërmimeve të ndryshme do të vendoset sistemi i ventilimit të hapësirës së hallës prodhuese, prandaj në njërin anë të murit do të vendosën ventilatorët me filtra për pastrimin e ajrit, kurse në anën tjetër të murit do të vendosen hapjet për hyrjen e sasisë së ajrit të pastër aq sa

është nxjerrë me anë të ventilatorëve, gjithashtu aroma e pakëndshme do të zvogëlohet përmes ajrimit përmes dritareve të vendosura në objekt;

- Do të bëhet kontrollimi i rregullt i pajisjeve dhe sistemit të ventilimit ashtu që pjesët e dëmtuara të ndërrohen. Në kushtet e udhëheqjes së procesit të prodhimit sipas standardeve të projektimit dhe me kontroll të mirëfilltë të pajisjeve për filtrim nuk ekziston rreziku që ndotja e ajrit të jetë mbi vlerat maksimale të lejuara të materieve ndotëse të caktuara si pas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Do të bëjë matjen e cilësisë të ajrit, vlerat e fituara do të krahasohen dhe nuk guxojnë të jenë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes. Vlerat e fituara në bazë të matjeve do të dorëzohen në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, intervali i matjeve do të kryhet në bazë të përcaktimit me aktet ligjore dhe në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

8.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë dhe ujë

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës të ndërtimit dhe zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në objektet e fabrikës, mbetjet do të grumbullohen dhe pastaj do të iu jepen kompanive që mbledhin mbeturinat në përputhje me ligjet në fuqi.


Mbetjet e ngurta komunale nga punonjësit e fabrikës do të hidhen në kontejnerë dhe të merret nga kompania kompetente e shërbimeve komunale në vendin e saj depozitave. Trajtimi i mbeturinave komunale i nënshtrohet Ligjit për menaxhimin e mbeturinave. Mbetjet nga rrjetat e polietilenit do të grumbullohen në qese dhe mund të hidhen në to vendi i depozitimit të mbeturinave komunale, ose mund të shitet si lëndë e parë.

Në rastin kur kemi ndonjë avari dhe kemi ndotje të dheut, sasia e dheut të kontaminuar largohet dhe dërgohet në depo apo vende speciale, ndërsa sasia e njëjtë e dheut plotësohet me dhe të përshtatshëm për atë pjesë të ambientit.

Edhe pse në Fabrikën për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit nuk zhvillohen procese që gjenerojnë ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj e dheut ujërave nëntokësore, por ndotja ndodh si që e kemi përshkruar në pasuset e mësipërme. Në fabrikë duhet të jete në funksion sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipulative dhe të dërgohen në gropën sedimentuese për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura. Duhet të ndërtohet separatori që përmes mureve në disnivele të bën ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat të ndotura dhe i deponon në pesetën

e posaçme, ku pas mbushjes së pusetës duhet të pastrohet nga ndërmarrjet e licensura për pastrimin e seperatorëve. Seperatorit duhet të përmbush kriteret teknike që janë të parapara me rregullore dhe normativa në fuqi. Duhet të ndërtohet gropa septike për trajtimin e ujërave të zeza e pastaj pas gropës septike ujërat e trajtuara të dërgohen në bunarin filtrues. Ujërat e trajtuara në separator dërgohen në bunarin filtrues.

Ujërat nga seperatori nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate mbi 1mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.



Përpos masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara në pasuset e mësipërme investitori duhet të i ndërmerr edhe këto masa:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative hapësirat operationale të mbulohen me beton ose asfalt.
- Furnizimi me ujë si dhe për nevoja tjera që shfrytëzohen për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajisjet për zjarrfikje bëhet nga rezervuari i ujit.
- Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat e përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm duhet të grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën në separator.
- Ujërat fekale nga nyjat sanitare përmes gypave duhet të dërgohen në gropën septike.
- Duhet rregullisht të bëhet kontrollimi i seperatorit pas mbushjes duhet bërë pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji duhet të deponohen në enë të posaçme dhe pastaj

të dërgohen në trajtim të mëtëjshëm sipas ligjit për trajtimin e materieve të rrezikshme.

- Duhet të vendoset kontejneri adekuat i pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tij duhet të dërgohet për zbrastje në deponi regjionale.
- Duhet të vendosen enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lëngëta.
- Duhet të bëhet mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe asfaltuara me barë dhe drunjë dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

8.3. Masat për mbrojtje nga zhurma

Në Fabrikë do të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit.

Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standardet dhe rregulloret në Republikën e Kosovës.

Në rast se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë do të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varësi nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës (kufje).

Zhurma e gjeneruar gjatë procesit të prodhimit duhet të jetë në kufijtë e lejueshëm në përputhje Ligjin Nr. 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma). Sipas kësaj zgjidhjeje vendndodhja në fjalë është e vendosur në një zonë banimi (megjithëse kjo është një zonë përdorim i përzier sepse përveç strehimit individual në vendndodhja gjithashtu përfshin impiante për përpunimin e drurit dhe një prizë më të madhe me pakicë objekte).

Nivelet e lejueshme të zhurmës për një zonë banimi janë:

- Zhurma ditore (7-19 orë) 55 dB;
- Zhurma e mbrëmjes (19-23 orë) 55 dB;
- Zhurma e natës (23-7 orë) 45 dB.

Zhvilluesi i projektit duhet të bëjë korrigjimin e zhurmës ku konstatohet se niveli i tij është rritur. Korrigjimi i nivelit të zhurmës duhet të jetë bëhet duke zëvendësuar pjesët individuale përgjatë vijës së procesit teknologjik prodhimi ose duke vendosur barriera specifike në vende nivele të rritura të zhurmës, ose nga zhvendosje të makinave (policë dhe makina për gurë) që lëshojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar. Masa në rast të ndonjë aksidenti.

8.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vije deri te ndikimet në florë dhe faunë por ato janë shumë të pakta.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk do të kemi zhdukje të vegetacionit pos nga sipërfaqet manipulative, nga sipërfaqja nën pajisjet e fabrikës, do të thotë se kemi të bëjmë me përqendrim të vogël të polutantëve. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative. Kompania nuk duhet të deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar. Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve prodhuese ne objektet e fabrikës në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë duhet të merren masa për neutralizimin e tij në mënyrë që të mos dëmtohet bota bimore. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania do të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, cilësinë e ajrit, ujit etj.

8.5. Masat e marra për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale

Fabrika do të përgatis planin e intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike. Do të përgatitet plani i mbrojtjeve nga zjarri sipas legjislacionit në fuqi për emergjenca. Oborri i fabrikës të thuret me tel gjembor.

Do të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera.

Do të merren të gjitha masat e sigurisë për kycjen e automjeteve transportuese në rrugë pa penguar komunikacionin.

Do të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

8.6. Masat rehabilituese

Pas përfundimit të shfrytëzimit dhe përfundimit të jetëgjatësisë së fabrikës kjo varet nga pronari se a do të vazhdojë me këtë projekt apo do të përfundojë aktivitetin prodhues. Pas këtij afati të gjitha pajisjet duhet të çmontohen dhe të vendosen në lokacionin tjetër apo në bazë të leverdisë së kompanisë të shiten si material i vjetruar, kurse pjesët metalike dhe objektet ndihmëse të demolohen dhe dërgohen në deponi regjionale.

Nga proceset teknologjike do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara dmth substrate të papërshtatshme (sterile) për rikultivim.

Duhet të bëhet mbushja e hapësirës së krijuar nga shfrytëzimi, për mbushjen e kësaj hapësire dhe kthimin e tyre në gjendje të përafërt me mjedisin rrethues dhe nga ngastra që do të jenë të përshtatshme për rikultivim. Rikultivimi i sipërfaqeve të shfrytëzuara duhet të kryhet edhe gjatë shfrytëzimit dmth mbushjen në të njëjtën kohë të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që gjatë procesit të shfrytëzimit dhe pas përfundimit të shfrytëzimit, sipërfaqet e degraduara, prapë të kthehen në funksionin e saj primar dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Për të qen rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të kryhen këto faza të procesit të rikultivimit:

- Rikultivimi teknik
- Rikultivimi agroteknik dhe
- Rikultivimi biologjik

Me rikultivimin teknik do të krijohet profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret për nevoja tjera si psh. për mbjelljen e fidanëve të ndryshme(pemëve) frytdhënëse apo edhe mbjelljen me të lashtat bujqësore.

Për formimin e shtresë së sipërme sipërfaqësore produktive të tokë parashihet shtresimi i shtrese të dheut deri 50 cm.

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë fillon me analizimin e substratit të krijuar për të përcaktuar vetit agrokimike dhe pedologjike, ku pastaj në bazë të analizave propozohen masat agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.

Për të llogaritur numrin e fidanëve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend sipas relacionit:

$$N_f = S/axb$$

Ku:

N_f - numri i fidanëve

S - paraqet sipërfaqen,

a - paraqet distancën në mes rendeve ,

b - paraqet distancën në mes fidanëve.

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshe relative e të gjitha elementit të ekosistemit siq

janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtari bujqësore. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit

Rikultivimi i ngastrave të shfrytëzuara do të kryhet në marrëveshje dhe mbikëqyrje të inspektorëve të pushtetit lokal dhe nga inspektorët e MMPH.

9.PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me “Metal - Construzion” SH.P.K., fabrika për prodhimin e rërës abrazive nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit, gjatë zhvillimit të aktivitetit industrial mund të paraqiten disa pasoja të kufizuara negative mbi mjedisin, të cilat lidhen kryesisht me procesin e përpunimit të skorjeve dhe lëvizjen e materialeve brenda objektit. Burimi kryesor i ndikimeve është gjenerimi i pluhurit gjatë thërrmimit dhe sitjes, i cili, nëse nuk kontrollohet, mund të ndikojë në cilësinë e ajrit në hapësirën e brendshme dhe zonat përreth.

Një tjetër ndikim potencial lidhet me mbetjet teknologjike. Në rast të menaxhimit jo të duhur, këto mbetje mund të kontaminojnë tokën ose të krijojnë rrezik për ujërat nëntokësore, sidomos nëse derdhjet nuk trajtohen menjëherë. Gjithashtu, qarkullimi i mjeteve transportuese mund të shkaktojë zhurmë lokale dhe ndotje të lehtë akustike. Po ashtu rrezik tjetër mund të jetë energjia eklektikë, e cila mund të shkaktojë ndonjë djegie të makinerisë.

Megjithatë, të gjitha këto pasoja janë të menaxhueshme dhe mbeten të ulëta nëse zbatohen masat teknike dhe organizative për kontrollin e pluhurit, trajtimin e mbetjeve, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mbikëqyrjen e aktivitetit në mënyrë të rregullt.

10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi i ndikimeve mjedisore është një proces kyç për menaxhimin e aktiviteteve industriale. Ai është i domosdoshëm për të siguruar që operacionet e fabrikës, nuk dëmtojnë mjedisin dhe për të përmbushur kërkesat ligjore. Aktivitetet e fabrikës për prodhimin e rërës abrazive(gërryerjes) nga skorjet e Nikelit dhe Bakrit, kërkojnë një monitorim të vazhdueshëm dhe të sistematizuar të treguesve mjedisorë, përfshirë cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës. Kjo ndihmon në identifikimin e shpejtë të ndotësve dhe të ndikimeve negative që mund të ndodhin. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen rregullisht për të siguruar se ato përputhen me standardet e caktuara dhe me legjislacionin përkatës. Çdo rast i ndotjes ose shkeljes së standardeve do të trajtohet me seriozitet. Nëse identifikohen ndikime negative, do të merren masat e nevojshme për të adresuar situatën, përfshirë ndalimin e aktiviteteve që shkaktojnë ndotje dhe implementimin e masave të zbutjes. Çdo rast i ndotjes që tejkalon normat e lejuara do t'i raportohet organit kompetent, në përputhje me ligjet e aplikueshme, për të siguruar transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Raportimi është një proces i rëndësishëm që siguron informacion të detajuar mbi gjendjen e mjedisit dhe ndikimet e aktiviteteve të qendrës së mbeturinave. Raportimi do të kryhet nga një individ i autorizuar nga menaxheri i kompanisë. Ky person do të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, si dhe për përgatitjen e raportit. Në raport do të përfshihen të dhëna të detajuara për monitorimin e parametrave mjedisorë që kërkohen në Pëlqimin Mjedisor, i cili lëshohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI). Këto të dhëna mund të përfshijnë:

- Emissionet e gazrave ndotës.
- Cilësia e ujit dhe ndotësit në ujëra të mbeturinave.
- Parametrat e cilësisë së tokës.

Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

11. PËRFUNDIM

Ndikimi i punës së Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit në mjedis është në nivelin e vlerave të duhura të rekomanduara nga Ligji për Mbrojtjen në Mjedis.

Ndikimi në tokë, ajër është i vogël dhe si i tillë mund të neglizhohet, kurse ndikimi në ujë mund të kontrollohet dhe të monitorohet dhe të raportohet në fund të çdo viti kalendarik sipas kërkesës së Ministrisë.

- Pajisjet dhe mjetet kundër zjarrit duhet të jenë të testuara dhe brenda afatit të përdorimit.
- Të gjitha pajisjet tjera të instaluar në reparte duhet të ekzistojë testi adekuat mbi përdorimin e tyre dhe mbrojtje në punë.
- Të përcillet akumulimi dhe largimi i ujërave të ndotura nga pusetat (gropat septike) por nëse instalohet sistemi për pastrimin e ujërave të ndotura atëherë është e nevojshme që të përcillet cilësia e ujërave në dalje nga separatori apo fundërruesi-gropa sedimentuese.

Zbatimi i këtij raporti, për aktivitetin e Fabrikës për prodhimin e rërës abrazive (gërryese) nga skorjet e Nikelit në këtë lokacion nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm, edhe të eliminohen.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë MMPH dhënien e mendimit për Pëlqimin Mjedisor

12. FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE

	KOSTO INVESTIVE E PROJEKTIT PËR “METAL - CONSTRUZION” SH.P.K. - PROJEKTIT	
1	Dozeri primar me dhanes	39,000.00 €
2	Larësja me spirale	23,000.00 €
3	Shiriti transportues	10,000.00 €
4	Dozeri sekondar me dhanes	39,000.00 €
5	Elevatori me korpa	5,000.00 €
6	Rezervuari për deponimin e materialit të lare me sistemin për zbrazje	8,000.00 €
7	Sistemi për pastrimin e ujit	19,000.00 €
8	Transportuesi kërmillor për fraksionin 1 për mbushjen e peshores automatike	6,000.00 €
9	Transportuesi kërmillor për fraksionin 2 për mbushjen e peshores automatike	6,000.00 €
10	Rezervuari me peshore automatike për matjen dhe mbushjen e thasëve jumbo	12,000.00 €
11	Komanda për kontrollin energjetik	18,000.00 €
Kosto totale investive për te tri objektet		185,000.00 €

“Metal - Construzion” SH.P.K.

13. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *Te dhënat nga Investitori,*
- <https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/pzhk.pdf>
- <https://geoportal.rks-gov.net/portal/main>
- https://www.google.com/maps/@42.5624032,21.2220765,409m/data=!3m1!1e3?entry=ttu&g_ep=EgoyMDI1MTIwMi4wIKXMDSoASAFQAw%3D%3D
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS](#)
- [UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHITETËROR TË MBETURINAVE](#)